



DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Maj 2026



DREJTORI I DOGANAVE TAKIM ME AGJENTËT DOGANORË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, u takua me përfaqësues të agjencive doganore në Degët Doganore Tiranë dhe Durrës, në kuadër të një serie bashkëbisedimesh me komunitetin e biznesit dhe aktorët kryesorë të procesit doganor. Gjatë bashkëbisedimit, u theksua rëndësia e rolit që agjentët doganorë luajnë si një hallkë ndërmjetëse mes operatorëve ekonomikë dhe administratës doganore.

Në këtë kuadër, Drejtori i Përgjithshëm nënvizoi se komunikimi i drejtpërdrejtë dhe periodik me agjentët doganorë është thelbësor për garantimin e një zbatimi sa më korrekt të legjislacionit doganor. "Niveli i profesionalizmit tuaj reflekton jo vetëm tek subjektet që përfaqësoni, por edhe në performancën e sistemit doganor në tërësi. Për këtë arsye, kërkohet përgjegjshmëri maksimale në çdo hallkë të procesit," u shpreh ai.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e agjencive doganore vlerësuan rëndësinë e këtyre takimeve, si një platformë e hapur komunikimi dhe shkëmbimi, duke theksuar nevojën për bashkëpunim më të ngushtë, trajnime të vazhdueshme dhe qartësi në zbatimin e procedurave. Ata shprehën gatishmërinë për të rritur nivelin e përgjegjshmërisë dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit në proceset doganore.



ZGJIDHET PROBLEMATIKA ME ITALINË PËR IMPORTIN E VERËS NGA KANTINAT E VOGLA

Doganat zgjidhin problematikën me Italinë për importin e verës nga kantinat e vogla, deri në 10 mijë hektolitra, të cilat përfitojnë diferencim akcize. Në një njoftim zyrtar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Italiane ka informuar Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave Shqiptare se, sa i përket propozimit për zgjidhjen e situatës aktuale të bllokimit që po prek importet e verës nga Italia në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin italian në fuqi, veçanërisht nenin 48 të Dekretit Legjislativ nr. 82/2005 ("Kodi i Administratës Digjitale"), Posta Elektronike e Certifikuar (PEC) ka vlerë juridike për identifikimin e dërguesit dhe marrësit të dokumentit.

Në këtë rast, ajo përfaqëson ekuivalentin e një letre të regjistruar me kthim përgjigjeje, të dërguar nga Ministria e Bujqësisë, Sovranitetit Ushqimor dhe Pyjeve (MASAF) drejt kantinave të verës të interesuara për përfitimin e reduktimit të akcizës, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Dogana Shqiptare fton të gjithë importuesit të vijojnë importet sipas njoftimit të mësipërm.

TAKIMI I 31-TË I RRJETIT TË KOORDINATORËVE KOMBËTARË TË PROGRAMIT CUSTOMS TË BE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Komisionin Europian, organizoi Takimin e 31-të të Rrjetit të Koordinatorëve Kombëtarë të Programit "EU Customs", me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të administratave doganore të vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe vendeve kandidatë. Aktiviteti u fokusua në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet administratave doganore, shkëmbimin e eksperiencave mbi zbatimin e programit "EU Customs", si dhe diskutimin e prioritetëve të ardhshme në funksion të modernizimit dhe harmonizimit të sistemeve doganore europiane.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, vlerësoi rëndësinë strategjike të Programit "EU Customs" për Administratën Doganore Shqiptare dhe procesin e integritimit evropian të vendit. Ai theksoi se përmirësimi me përpikmëri dhe kushteve në fushën doganore mbetet një nga prioritetet kryesore të administratës doganore në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

ZGJATJET ORARI I SHËRBIMIT NË PIKËN KUFITARE QAFË - BOTË

Duke nisur nga data 11 Maj, autoritetet doganore greke në doganën e Mavromatit, në Pikën e Kalimit Kufitar Qafë - Botë, kanë zgjatur me dy orë orarin e shërbimit për përpunimin e qytetarëve dhe automjeteve. Sipas njoftimit zyrtar të palës greke, pika kufitare do të funksionojë çdo ditë nga ora 05:00 deri në 23:00 me orën shqiptare, përkatësisht nga ora 06:00 deri në 24:00 me orën greke. Më herët, orari i funksionimit ka qenë nga ora 06:00 deri në 22:00 me orën shqiptare.

Zgjatja e orarit synon reduktimin e kohës së pritjes dhe shmangien e radhëve, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe garantimin e një kalimi më të shpejtë e më efikas për të gjithë udhëtarët.



SEKUESTROHEN ILAÇE TË PADEKLARUARA NË PORTIN E DURRËSIT

Gjatë kontrolleve të ushtruara në Portin e Durrësit, strukturat e Doganës në bashkëpunim me Policinë Kufitare kanë evidentuar një rast të futjes së paligjshme të ilaçeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjatë kontrollit në vijën e dytë, në një mjet të ardhur nga Bari, Itali, u konstatuan 4 kuti me medikamente të ndryshme, të padeklaruara dhe pa dokumentacion shoqëruar përkatës. Ilaçet u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, ndërsa drejtuesi i mjetit dhe materialet përkatëse iu referuan organeve kompetente për veprime të mëtejshme procedurale.

NIS ZBATIMI I LIQJIT TË FALJES DHE SHUARJES SË DETYRIMEVE DOGANORE

Ka hyrë në fuqi udhëzimi për zbatimin e ligjit nr. 86/2025 "Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë", i cili përcakton procedurat dhe afatet për subjektet debitoare që përfitojnë nga falja e detyrimeve.

Në kuadër të këtij procesi, Administrata Doganore do të vijojë evidentimin dhe trajtimin e detyrimeve të papaguara sipas periudhave përkatëse, duke u krijuar subjekteve mundësinë për të përfituar nga fshirja ose shuarja e një pjese të detyrimeve, gjobave dhe kamatëvonesave.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave fton të gjitha subjektet debitoare të paraqiten pranë degëve doganore përkatëse për të verifikuar situatën e tyre financiare, për të evidentuar nëse përfshihen në dispozitat e ligjit dhe për të vijuar procedurat administrative përkatëse.

Zbatimi i këtij ligji synon të lehtësojë barrën financiare për bizneset, të nxisë formalizimin dhe të krijojë mundësi për mbylljen e detyrimeve të prapambetura nëpërmjet procedurave lehtësuese të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

DREJTORI I DOGANAVE NË TAKIMIN E NIVELIT TË LARTË ME UNCTAD NË GJENEVË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave z. Besmir Beja mori pjesë në një takim të nivelit të lartë në Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD), në Gjenevë, ku zhvilloi takime me z. Renaud Massenet, Shef i Programi Asycuda (ASYCUDA UNCTAD), z. Constatin Ciuta, Menaxher i Programit Asycuda dhe z. John David ekspert i sistemeve të teknologjisë së informacionit, drejtuesi i ekipit të zhvillimit ASY5 (ASYCUDA UNCTAD).

Në diskutimet dypalëshe, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave theksoi rëndësinë e zbatimit të Strategjisë për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar me Sistemet e Bashkimit Europian, për periudhën 2025-2030, së bashku me planin e veprimit përkatës.

Sipas Z. Beja, zbatimi strategjisë së miratuar nga Qeveria Shqiptare, synon që deri në vitin 2030 Shqipëria të disponojë një infrastrukturë të teknologjisë së informacionit për doganat tërësisht të harmonizuara me Kodin Doganor të BE-së, duke lehtësuar integrimin gradual në tregun e përbashkët evropian dhe duke konsoliduar procesin e anëtarësimin.



NË TAKIMIN RAJONAL TË CEFTA-S PËR TREGTINË ELEKTRONIKE

Ekspertë të tregtisë elektronike dhe procedurave doganore nga të 7 Palët e CEFTA-s u mbledhën këtë javë në Shkup, në kuadër të projektit EU-4Trade, të mbështetur nga Bashkimi Europian dhe Gjermania, me qëllim përmirësimin e procedurave të tregtisë online në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Takimi rajonal, i organizuar në bashkëpunim me Sekretariatit e CEFTA-s, u fokusua në identifikimin e zgjidhjeve praktike për përshpejtimin e procedurave doganore, rritjen e cilësisë dhe shkëmbimit të të dhënave digjitale, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet administratave doganore, si dhe përafrimin me reformat e ardhshme të Bashkimit Europian në fushën doganore dhe të TVSH-së.





DREJTORIA E
PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Maj 2026

DREJTORI I DOGANAVE PRET AMBASADORIN E INDISË NË SHQIPËRI

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, zhvilloi një takim zyrtar me Ambasadorin e Indisë në Shqipëri, Sh.T.Z. Ravindra Prasad Jaiswal, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy vendeve. Palët diskutuan mbi mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në fushën doganore, lehtësimin e procedurave tregtare, shkëmbimin e eksperiencave profesionale dhe forcimin e kapaciteteve administrative në përputhje me standardet ndërkombëtare.



MASAT PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË SEZONIT TURISTIK NË PORTIN E DURRËSIT

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, së bashku me Ministrin e Financave, Petrit Malaj, zhvilluan një vizitë pune në Degën Doganore në Portin e Durrësit, në kuadër të masave të ndërmara për menaxhimin e fluksit të sezonit turistik veror, forcimin e sigurisë dhe lehtësimin e procedurave për qytetarët, turistët dhe operatorët ekonomikë. Ministri i Financave vlerësoi rolin e Administratës Doganore në menaxhimin e sezonit turistik dhe theksoi rëndësinë e marrjes së masave për lehtësimin e qarkullimit të turistëve dhe qytetarëve. Nga ana e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, bëri të ditur se administrata doganore ka marrë të gjitha masat për përforcimin e shërbimeve gjatë sezonit veror, si në aspektin operacional ashtu edhe në atë të sigurisë. Gjatë takimit me strukturat doganore u diskutuan edhe objektivat e Doganës Durrës për sezonin 2026, me fokus uljen e kohës së pritjes dhe lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe turistëve, duke ruajtur njëkohësisht kontrollin dhe analizën e riskut. Konkretisht, synohet që koha e pritjes për mjetet private të reduktohet në më pak se 2 minuta, ndërsa për kroçerat në më pak se 20 minuta.



NË KOMITETIN E PËRHERSHËM TEKNIK TË ORGANIZATËS BOTËRORE TË DOGANAVE

Administrata Doganore Shqiptare mori pjesë në Sesione 251-të dhe 252-të të Komitetit të Përhershëm Teknik (Permanent Technical Committee - PTC) të Organizatës Botërore të Doganave, të zhvilluara në Bruksel, Belgjikë, me pjesëmarrjen e mbi 280 përfaqësuesve nga administratat doganore, organizatat ndërkombëtare dhe sektorit privat. Takimi u fokusua në modernizimin e operacioneve doganore, zhvillimet teknologjike, tregtinë elektronike ndërkufitare dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për përballimin e sfidave të reja në fushën doganore.

Gjatë sesioneve u diskutuan dhe u miratuan një sërë instrumentesh dhe mekanizmesh të rëndësishëm që mbështesin transformimin modern të administratave doganore. Një vëmendje e veçantë iu kushtua sfidave që lidhen me rritjen e tregtisë elektronike ndërkombëtare, menaxhimin e riskut, cilësinë e të dhënave dhe përdorimin e teknologjive të avancuara për lehtësimin e tregtisë së ligjshme dhe forcimin e kontroleve doganore.



TAKIMI I GRUPIT TË EKSPERTËVE TË PERFORMANCËS SË BASHKIMIT DOGANOR NË LISBONË


Përfaqësues të Administratës Doganore Shqiptare morën pjesë në takimin e Grupit të Ekspertëve të Performancës së Bashkimit Doganor (Customs Union Performance - CUP), i zhvilluar më 20-21 maj 2026 në Lisbonë, Portugal. Gjatë takimit u trajtuan çështje që lidhen me përgatitjen e Raportit Vjetor CUP 2025, procesin e mbledhjes dhe validimit të të dhënave, analizën e rezultateve të performancës për vitin 2025, si dhe metodologjinë e punës për fazat e ardhshme. Në fokus të diskutimeve ishin gjithashtu zhvillimet më të fundit në kuadër të Reformës Doganore të Bashkimit Europian, heqja e pragut të minimis, si dhe evolucioni i flukseve të tregtisë elektronike (e-commerce).



TRAJNIM PRAKTIK PËR NJËSINË E KONTROLLIT NË AEROPORT, ACU

Administrata Doganore Shqiptare, në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), zhvilloi në Tiranë trajnimin praktik bazë për Njësinë e Kontrollit në Aeroportin e Rinastit (Airport Control Unit - ACU), në kuadër të projektit rajonal "Veprimi i Përbashkët BE-UNODC për promovimin e shtetit të së drejtës dhe qeverisjes së mirë përmes masave të targetuara të kontrollit kufitar në porte dhe aeroporte në Europën Juglindore - Faza II (2024-2027)".

Trajnimi u organizua nga Programi i Kontrollit të Pasagjerëve dhe Mallrave (PCCP) i UNODC-së dhe synon forcimin e kapaciteteve të strukturave doganore dhe policore në identifikimin, parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare, përmes teknikave moderne të kontrollit dhe analizës së riskut në aeroport.



DOGANA SHQIPTARE NË MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave mori pjesë në aktivitetin dyditor me temë "Lufta kundër trafikimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore", organizuar në kuadër të projektit "Ngritja e kapaciteteve lokale dhe bashkëpunimi në zbatimin e ligjit për të luftuar trafikimin e paligjshëm të trashëgimisë kulturore shqiptare".

Ky aktivitet mblodhi së bashku profesionistë të trashëgimisë kulturore dhe përfaqësues të institucioneve të zbatimit të ligjit, me synimin për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për të rritur kapacitetet në parandalimin dhe goditjen e trafikimit të paligjshëm të objekteve me vlerë historike dhe kulturore.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka një rol kyç në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare. Si institucioni përgjegjës për kontrollin e lëvizjes së mallrave në kufi, Dogana është në vijën e parë të identifikimit dhe ndalimit të tentativave për nxjerrjen e paligjshme të objekteve të trashëgimisë kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë.

FORCIMI I KONTROLLIT TË EKSPORTEVE DHE RITJES SË STANDARDEVE TË SIGURISË

Administrata Doganore mori pjesë në takimin dyditor të organizuar në Tiranë, në kuadër të Projektit P2P të Bashkimit Europian për Kontrollin e Eksportit të Mallrave me Përdorim të Dyfishtë (P103) dhe Projektit të Ndërgjegjësimit të BE-së COARM VII, për forcimin e kapaciteteve institucionale në fushën e kontrollit të eksporteve strategjike, mallrave ushtarake dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Gjatë aktivitetit u trajtuan ndryshimet më të fundit në legjislacionin shqiptar për kontrollin shtetëror dhe ndërkombëtar të transferimeve të mallrave ushtarake dhe artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, në funksion të përafritimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor shqiptar me standardet dhe acquis të Bashkimit Europian.

Në fokus të diskutimeve ishte edhe roli i Administratës Doganore në kontrollin e mallrave strategjike, vlerësimin e riskut, zbatimin e procedurave të kontrollit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalimin e transferimeve të paligjshme dhe garantimin e sigurisë në zinxhirin tregtar.